



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:088290

Datë: 16.10.2024

Numri i dokumentit: 06305336

**C.nr.1642/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.O., A.O. dhe K.O. që të gjithë nga fshati Kobaj, Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. A.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurve I.M. nga Prizreni, Sh.M. nga Prizreni, si dhe S.M. nga fshati Planej, Komuna e Prizrenit për çështjen juridike me objekt kontesti vërtetim pronësie, më datë 16 tetor 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. KONSTATOHET** së është tërhequr padia me numër C.nr.1642/24, të paditësve N.O., A.O. dhe K.O. që të gjithë nga fshati Kobaj, Komuna e Prizrenit, kundër të paditurve I.M. nga Prizreni, Sh.M. nga Prizreni, si dhe S.M. nga fshati Planej, Komuna e Prizrenit për çështjen juridike me objekt kontesti vërtetim pronësie
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësit N.O., A.O. dhe K.O. që të gjithë nga fshati Kobaj, Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tyre Av. A.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 19.03.2024, kanë ushtruar padi kundër të paditurve I.M. nga Prizreni, Sh.M. nga Prizreni, si dhe S.M. nga fshati Planej, Komuna e Prizrenit për çështjen juridike me objekt kontesti vërtetim pronësie

I autorizuar i paditësve Av. A.Sh., me parashtrësën e datës 30.09.2024, e ka njoftuar gjykatën se lidhur me këtë çështje juridike kontestuese, palët kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj në bazë të mungesës së interesit juridik i kërkon gjykatës që padia e datës 19.03.2024, të konstatohet e tërhequr.

Numri i lëndës: 2024:088290

Datë: 16.10.2024

Numri i dokumentit: 06305336

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 457 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**C.nr.1642/24, me datë 16.10.2024**

**Gjyqtari  
Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.